

MERRNI E HANI...



MERRNI E PINI...

# Jeta Liturgjike

Viti I Nr. 9, Nëntor 2005



***Martirët e Shqipërisë  
në kohën e komunizmit***

# TË GJITHË SHENJTËRIT

## 1 nëntor

Të përkujtossh shenjtërit do të thotë të bashkosh zërin tonë dhe zemrën e atyre, që tashmë ndodhen në lumturinë e përjetshme dhe që bekojnë Hyjin, i cili me dashurinë e tij, i ka thirrë që ta imitojnë në fjalë dhe vepra.

Qysh në fillim Kisha ka festuar dhe përkujtuar ata që kanë dhënë jetën e tyre për fenë (martirët) dhe gjatë shekujve - meshtarët, rregulltarët dhe laikët - që kanë dëshmuar dashurinë e tyre për Jezu Krishtin, duke dëshmuar fjalën dhe veprën e tij, përkundër vështirësive që kanë takuar gjatë jetës tyre.

Nëse sot në botë ekziston pak shpresë, është meritë e shenjtërve që na e kanë trashëguar. Nëse ekziston akoma vëllazëri, duhet të jemi mirënjohës këtyre dëshmitarëve, që me guxim e kanë ruajtur nga urrejtja ndërmjet njerëzve. Nëse sot ndonjëri akoma buzëqesh një fëmiu ose një të moshuari, është meritë e shenjtërve, të cilët na kanë mësuar ta duam dhe ta respektojmë jetën.

Ndryshojnë kohërat dhe kushtet, në të cilën jeton dhe vepron Kisha, megjithatë ftesa për shenjtëri është gjithmonë e njëjtë. Ajo shfaqet në mënyra dhe forma të ndryshme, realizohet nga njerëzit sipas situatave dhe rrethanave në të cilat jetojnë, por shenjtëria e çdo kohe dhe e çdo njeriu është gjithmonë e bazuar në dashurinë ndaj Hyjit dhe ndaj të afërmit.

Në këtë ditë ne festojmë edhe shenjtërit që emrat e tyre nuk ndodhën në kalendar, që Kisha ende nuk i ka kanonizuar. Shpirti Shenjt ka një bashkim, pra një solidaritet ndërmjet banorëve të qiellit dhe të tokës. Pjestarët e trupit të Krishtit, bëjnë gjithmonë të njëjtën mënyrë jetese: nuk jetojnë, nuk

vuajnë dhe nuk vdesin vetëm. Është një lidhje që tejkalon çdo lidhje tokësore, sepse janë të përcaktuar me qëllim që të zgjasin deri në amshim. Kjo lidhje përjashton vetminë. Megjithatë duhet të dish të jetosh këtë jetë hiri. Ata që tashmë ndodhën lartë i luten Hyjit për ne dhe në shpresë në Zotin, na presin në festën e tyre të amshuar.

Kush janë shenjtërit?

Shenjtërit janë të varfërit në zemër. Të varfërit janë ata që kanë fituar ndaj dëshirës për të pasur dhe janë tërhequr nga bukuria e të dhuruarit.

I varfëri nuk mbështet jetën e tij në rërë, e cila është rrjedhojë e parasë, por e shkëmbit, që është e Hyjit: për këtë arsye çdo shenjt është i varfër dhe çdo i varfër është shenjt. Shenjtërit janë të butë dhe të mëshirshëm: pra janë ata që kanë fituar ndaj luftës brenda shpirtit të tij me armikun e tmerrshëm dhe të rrezikshëm, që quhet krenaria.

Kush ka fituar ndaj krenarisë, nuk mund të urrej askënd, sepse në zemrën e tij ka Hyjin dhe Hyji nuk mund të urrejë, por vetëm të dashurojë.

I buti ndien kënaqësi, sepse bashkimi me Hyjin bën që të mendojë dhe të veprojë siç mendon dhe vepron Hyji: dhe Hyji është përjetësisht i mëshirshëm.

Shenjtërit janë të pastërtit në zemër, pra ata që nuk kanë maska ose qëllime dytësore ose dy fytyra. Të pastërtit në zemër janë ata që jetojnë në çiltërsi dhe duke qenë të kthjelltë ne ndjenjat e tyre, janë të aftë të respektojnë të afërmin. Pastërtia e zemrës është liria e plotë: kush është i lirë në të vërtetë, nuk ka nevojë që të krijojë skllëvër përreth tij. Ndërsa kush s'është i pastër

është i paaftë të dojë: do të përdorë të tjerët, por nuk do t'i dojë kurrë!

A arrijmë që të kuptojmë se pastërtia është një kusht i pamohueshëm për paqen ndërmjet njerëzve! Shenjtërit janë ata, të cilët qajnë dhe vuajnë, por ruajnë shpresën: shpresa në Atë që nuk dëshpron dhe do të fshijë çdo lot.

“Ty o Hyj të lavdërojmë, ty o Zot të dëshmojmë.

Ty o At i amshueshëm bota mbarë të bindet.

Ty engjëjt mbarë-mbarë, ty qielli e fuqitë të gjitha.

Ty Kerubinët e Serafinët, pa pushim të brohorasin:

Shenjt, shenjt, shenjt, Zoti dhe Hyji i ushtrive.

Ty të dëshmon e lumnueshmja vallja apostullore.

E për rrokuli të tokës, të lavdëron shenjta Amë Kishë” (Te Deum).

### DITAE PURGATORËVE (Dita e të gjithë të vdekurve) 2 nëntor

Në përkujtimin e të vdekurve - ata që kanë përshkuar ecjen tokësore dhe tashmë ndodhen në jetën e amshuar - liturgjia na bën që të dëgjojmë himnin 'Dies irae' (Dita e hidhërimit), për shumë është i frikshëm, sepse në këtë ditë do të shfaqet Gjykatësi 'rex tremendae maiestatis'.

Gjykimi s'mund të harrohet, sepse është gjykimi i Shëlbuesit tonë: Kisha këtu në tokë predikon mëshirën e Hyjit, që kur është bërë njeri ka derdhur gjakun e tij për mbarë njerëzimin. 'Nuk kemi shpresuar dhe besuar në mënyrë të mjaftueshme në Zotin, i cili është shumë i fuqishëm, njëkohësisht shumë i mirë' (shën Tereza e Jezusit Fëmi).

Para misterit të vdekjes, çdo fjalë që

mund të themi në shikim të parë na duket, ose në të vërtetë është, e padobishme. Do të ishte më mirë sikur të qëndronim në qetësi, me lot për faqe dhe me një hidhërim të thellë në zemër. Ky do të ishte qëndrimi i njeriut të sotëm, pra bëhet fjalë për një qëndrim natyral e spontan. Çdo gjë reduktohet në lotë e dhimbje.

Megjithatë qëndrimi i të krishterit tejkalon të gjitha këto fjalë, veprime dhe mendime. I krishteri beson se vdekja dhe mbi të gjitha vdekja e tij, nuk është fundi i çdo gjëje, por është një fillim.

Jezusi na ka thënë: 'Unë jam jeta'. Pra jeta është frymëmarrje, dashuri, mënyrë e të jetuarit bashkë. “Dhe, sikurse në Adamin vdesin të gjithë njerëzit, ashtu nëpër Krishtin të gjithë njerëzit do ta rifitojnë jetën”. (1 Kor 15,22) “Unë jam Ringjallja dhe Jeta: kush beson në mua, edhe nëse vdes, do të jetojë” (Gjn 11, 25). Feja në Ringjalljen e Zotit, është themeli i lutjeve tona për ata që kanë vdekur: me qëllim që të jenë të pranuar në lavdi dhe të kalojnë në vendin e dritës dhe të paqes. Ata jo vetëm që besuan në Zotin, por nëpërmjet Pagëzimit vdqiën me të dhe me të do të kalojnë në jetën e re: që Zoti të plotësoi atë se çfarë ka filluar në Pagëzim.

“Të gjithë njerëzit kanë frikë vdekjen e trupit, por vetëm pak prej tyre kanë frikë vdekjen e shpirtit” (Shën Augustini).

Albert Jakaj



## E DIELA XXXII gjatë vitit

*Prandaj: rrini zgjuar se nuk e dini ditën as orën!*

**Leximi i parë:** *Urt 6, 12-16.* Urtia është veçori e Zotit. Kush dëshiron lehtë e gjen atë. Ajo iu dhurohet të gjithëve. Zoti është urtia që kërkon të na dhurohet.

**Psalmi 63 (62) *Shpirti im ka etje për ty, o Zot***

**Leximi i dytë:** *1 Sel 4, 13-18* Kjo pjesë e letrës së Palit dëshiron të largojë disa paqartësi rreth besimit të selanikasve në lidhje me ardhjen e dytë të Krishtit. Për ditën e Zotërisë duhet të përgatitemi, e jo vetëm të ëndërrojmë dhe presim kot atë ditë.

**Ungjilli Mt 25, 1-13**

*Në atë kohë, Jezusi u tregoi nxënësve të vet këtë shëmbëlltë: "Atëherë Mbretëria e qiellit do t'u përngjajë dhjetë virgjërave, të cilat morën dritëzat e veta e i dolën para dhëndrit. Pesë prej tyre ishin marroqe e pesë të mençura. Tashti, këto marroqet, morën me vete dritëzat, por nuk e morën vajin. Ndërsa ato të mençurat, morën me vete bashkë me dritëzat e veta edhe vaj në enë. Pasi dhëndri u vonua, u kotën të gjitha dhe i zuri gjumi. Rreth mesnatës u dha lajmi: 'Ja dhëndri! Dilni përpara!' atëherë të gjitha virgjërat u çuan dhe i rregulluan dritëzat e veta. Atëherë marroqet u thanë të urtave: 'Na jepni prej vajit tuaj se po na ndalen dritëzat.' Të mençurat u përgjigjën: 'Assesi! Që të mos na mungojë neve dhe juve, më mirë shkoni te tregtarët e bleni për vete!' Kur ato shkuan të blejnë, erdhi dhëndri e ato që ishin gati, hynë bashkë me të në dasmë dhe u mbyll dera. Më vonë ia behën edhe virgjërat tjera e thanë: 'Zotëri, o zotëri, na e çel derën!' Por ai u përgjigj: 'përnjëmend po ju them: nuk ju njoh!' Prandaj: rrini zgjuar se nuk e dini ditën as orën!"*

**Fjala e Zotit**

Leximet e sotit na flasin për një virtyt që gjithnjë e më shumë po i mungon shoqërisë sonë në përgjithësi, por edhe neve si besimtarë, e kjo është *urtia*. Në këtë frymë na flet leximi i parë, por edhe ungjilli ku bën fjalë për pesë vajzat e mençura e pesë të marra. Qëllimi i këtij fragmenti të ungjillit është që të theksojë rëndësinë e mençurisë dhe të vigjilencës, kujdesit në jetën tonë të përditshme, sepse ne nuk *dijmë çastin as momentin kur do të vjen Dhëndrri - Krishti*.

Në këtë drejtim mund të themi edhe këtë: Sot po jetojmë në një botë moderne e cila gjithnjë e më shumë po e përfshinë edhe shoqërinë tonë shqiptare. Në këtë kontekst mund të themi se si sot është ndërruar shkalla e vlerave. Në të kaluarën parim i njerëzve ka qenë që me djersë dhe me punë të ndershme të mbanë familjen. Nëna e cila i ka pranuar fëmijët si dhuratë e Zotit ka qenë nënë e urtë dhe fisnike; njerëzit kanë pasur më tepër ndjenja për njëri tjetrin, ka pasur më tepër respekt dhe njerzitet e tillë janë quajtur të mençur. Ndërsa sot ajo nënë që lind shumë fëmijë është e marrë, e prapambetur, ai djalë apo ajo vajzë e cila e ruan nderin e familjës, prapë quhet e prapambetur!? Sot është i mençur ai që me një fjalë di me *dredh e me zhredh!* Por një gjë e tillë në shikim vlenë vetëm para njerëzve, por jo edhe para Zotit.

*Një kryetar i një komune në Itali vendosë ta lenë detyrën e vet dhe të shkojë në kuvend për t'u bërë frat. Kur për këtë dëgjoi shoqëria e tij u befusua shumë dhe vendosën ta vizitojnë dhe ta bindin që ta lenë atë rrugë. Dhe kur shkuan tek ai i thanë: Ç'të gjeti që e lë shoqërinë tonë? Të kujtohet se sa avanturat e mira i kemi përjetuar së bashku. Hajde mjaft ke*

*qendruar këtu i mbyllur, eja me ne! Shiqoni, tha ai, edhe po të doja me ardhë me ju, nuk më lënë katër roje që janë te dera! Ma ç`po flet kështu, ne nuk pamë roje te dera, por edhe nëse ka, ti e di se kush jemi ne dhe shumë lehtë do t'i qerojmë hesapet me ta. Eja me ne! Dhe pasi shkuan te dera, frati i ri iu tha: Largoni prej këtu këto roje dhe unë do të vijë me ju! Ata u habitën së tepërmi sepse aty nuk kishte roje por vetëm katër fjalë të shkruara: Vdekja, gjyqi, parrizi dhe ferri.*

Nëse diçka në jetë është e sigurt atëher kjo është vdekja, e cila nuk ka të ndalur, nuk bënë dallime fetare, racore, gjinore. Dhe kur të vjenë ajo, e që ne nuk e dijme *as çastin as orën*, atëherë ne nuk kemi mundësi të përmirësohemi, por do të dalim ballafaqe para Zotit në Gjyqin e Tij. Dhe nuk është se neve na gjykon Zoti, por ne jemi ata që e dënojmë vetvetën. Nëse në këtë jetë jemi munduar me qenë të ndershëm, besnik, bujarë, të mëshirshëm atëherë ne do të bëhemi pjesëtarë të Mbretërisë qiellore, për të cilën në Bibël lexojmë se *çka syri njeriut nuk ka parë dhe veshi nuk ka dëgjuar, Zoti e ka bërë gati për njerëzit që i mbesin atij besnik*. Por nëse në këtë jetë kemi qenë *të marrë*, duke u dhënë vetëm pas të mirave materiale, kemi qenë dyfytirësh, tradhëtar fetarë dhe kombëtarë, jo njerëzorë, me vdekje neve do të na hapen dyert e ferrit, i cili po ashtu është i amshueshëm dhe në Bibël lexojmë se aty do të jetë *vaj dhe kërcëllim dhëmbësh*. Unë besoj dhe shpresoj se ne do të jemi mjaft të mençur për të zgjedhur rrugën e Zotit. Rrugën që na lanë amanet martirët tanë që sakrifikuuan gjithçka por nuk e tradhëtuan Krishtin. Mos të humbim tani në paqe atë që të parët tanë aq shumë flijuan dhe na e dorëzuan neve në luftë edhe në vuajtje.

Dhashtë Zoti që duke u munduar të jetojmë me nder në paqe dhe dashuri me

Zotin dhe të afërmin tonë, e kështu të bashkohemi një ditë bashkë me martirët tanë në Mbretërinë e Atit tonë qiellorë. Amen.

*Lutja e besimtarëve*

**Vëllëzër dhe motra, ne jemi bijë dhe bijat të Zotit, prandaj të frymëzuar me këtë bijësi, t'i drejtohem Atit tone qiellor: Dëgjoje, o Zot, lutjen tonë.**

- O Atë ne kemi nevojë për ndihmën Tënde, prandaj po të lutemi që fjala jote të na nxisë gjithnjë që të veprojmë për të mirën e shpirtit tone, të lutemi.
- Bota duke të mos njohur Ty dhe urdhërimet e tua, ndahet prej hirit tend, shndriti me dritën e Shpirtit tend të shenjt, të lutemi.
- Po të lutemi o Zot, edhe për familjet tona, ruaj në paqe, harmoni dhe dashuri, të lutemi.

**O Zot, dëgjo lutjet tona që i shprehem më zë dhe ato që kanë mbetur të fshehura në zemrat tona. Ti e di për çka ne kemi më së tepërmi nevojë. Na i jep të mirat që na nevojiten për shëlbimin e shpitrave tanë. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.**

Don Kolë ZEFI



## E DIELA XXXIII gjatë vitit

*U dëftove besnik në sende të vogla, hyr në gëzimin e zotërisë tënd!*

**Leximi i parë:** *Fu 31,10-13.19-20.30-31.* Janë këta rreshta kushtuar gruas, gjegjësisht nënave.

**Psalmi:** *128 (127) Lum njeriu që ecën udhës së Zotit.*

**Leximi i dytë:** *1 Sel 5, 1-6.* Pali vazhdon t'iu spjegon selanikasve besimin në ardhjen e Krishtit. Si duket ata ishin kureshtar për të ditur saktësisht se kur do të vjen Ai. Pali iu bën me dije se dita e ardhjes së Krishtit mbetet e panjohur. Por i krishteri e pret i gatshëm me lutje dhe punë të ndershme.

**Ungjilli** *Mt 25,14-30*

*Në atë kohë, Jezusi u tregoi nxënësve të vet këtë shëmbëlltëry: "Një njeri kur deshi të niset për dhe të largët, i thirri shërbëtorët e vet e ua dorëzoi pasuritë e veta. Njërit i dha pesë talenta, tjetrit dy e të tretit vetëm një: secilit sipas zotësisë së tij e u nis për udhëtim. Menjëherë ai që mori pesë talenta u çua dhe i shtiu në punë e me ta fitoi edhe pesë tjerë. Po ashtu, edhe ai që mori dy talenta, fitoi edhe dy tjerë. Kurse ai që mori vetëm një, shkoi, çeli një gropë në dhe, dhe e fshehi paranë e zotërisë së vet. Pas një kohe të gjatë, u kthye zotëria i atyre shërbëtorëve dhe kërkoi llogari prej tyre. E si doli para ai që kishte marrë pesë talenta, i qiti përpara edhe pesë tjerë e tha: 'Zotëri, ti më pate dhënë pesë talenta, ja, edhe pesë tjerë që i fitova.' I përgjigji zotëria i tij: "Të lumtë, shërbëtor i mirë e besnik! Pse u dëftove besnik në sende të vogla, do të bëj të parë mbi pasuri të mëdha: hyr në gëzimin e zotërisë tënd! U afrua edhe ai që kishte marrë dy talenta e tha: 'Zotëri, ti më pate dhënë dy talenta, ja, edhe dy tjerë, që i fitova.' I përgjigji zotëria i tij: "Të lumtë, shërbëtor i mirë, e besnik! Pse u dëftove*

*besnik në sende të vogla, do të bëj të parë mbi pasuri të mëdha: hyr në gëzimin e zotërisë tënd! Kur u afrua ai që kishte marrë vetëm një talent, tha: "Zotëri, duke të njohur se je njeri i ashpër, se korr ku nuk mbolle e mbledh ku nuk hodhe, u frikësova, e shkova dhe e fsheha talentin tënd në dhe: ja, tani gjënë tënde!" Zotëria i tij i përgjigji me këto fjalë: 'Shërbëtor i keq dhe përtac! E ke ditur se korr ku s'mblodha, mbledh ku nuk hodha, prandaj të është dashur ta shtish paranë time në bankë e në kthimin tim kisha marrë gjënë time me kamatë. Prandaj merrjani këtij talentin e jepjani atij që ka dhjetë talenta! Sepse, atij që ka do t'i jepet më e do të ketë me shumicë, e atij që s'ka, do t'i merret edhe ajo pakicë që ka! E shërbëtorin e pavlefshëm qiteni përjashta në terr, ku do të jetë vaj dhe kërcëllim dhëmbësh!'"*

### Fjala e Zotit

Në leximin e parë të kësaj së diele lexojmë për vlerën e madhe që ka gruaja gjegjësisht nëna. Ajo krahasohet me një visar që nuk mund të vlerësohet me asgjë. Ajo është bekim për bashkëshortin dhe familjen. Nuk thotë kotë populli ynë se gruaja i mbanë tre kënde të shtëpisë, ndërsa burri vetëm një. Pa dyshim është meritë e nënave tona që gjatë historisë duke i pranuar fëmijët me dashuri si dhuratë të madhe të Zotit nuk lejuan që populli ynë të asimilohet dhe për më tepër ato fëmijët e vet, me uratë në duar i kanë edukuar që të jenë krenaria e Zotit dhe krenaria e tyre. Këto nëna kanë ditur misionin e tyre të shenjtë që iu ka besuar Zoti. Ato kanë ditur të vuajnë për familjet e veta. Si është puna sot me nënat e reja? Ato e kanë humbur kuptimin për vuajtje! Ato nuk i pranojnë fëmijët me dashuri?! Sepse

fëmijët iu prishin planet që i kanë. Prindërit e sotit mendojnë vetëm në argëtim, në kënaqësitë e kësaj bote. Ata i japin rëndësi dhe kujdes vetëm hijësisë, bukurisë natyrore, por jo edhe asaj shpirtërore!

Për ta kuptuar më mirë pjesën e ungj. të sotshëm ta deshifrojmë ose më mirë me thënë t'i zbulojmë personazhet e kësaj shembëlltyre. Zotëria është vet Krishti, nënpunësit ose shërbëtorët jemi të gjithë ne. Talentat janë hiri dhe dhuratat tjera që na i ka dhënë Zoti të gjithë neve, dikuj më tepër e dikuj më pak. Pse ky dallim, veç është fshehtësi e Zotit. Rrugëtimi i tij është kalimi prej kësaj jete tek Ati, ndërsa kthimi i tij për të kërkuar llogari është ardhja e Tij e dytë kur ne do të takohemi ballafaqë me të. Kur do të vjen kjo ditë ne nuk e dimë. Dhe kjo as që është e rëndësishme. Më e rëndësishme është që ne të jemi të gatshëm, vigilent ose siç na thotë shën Pali të *mos flejmë dhe të mos jetojmë në terr!*

Vëllezër dhe motra, Zoti të gjithë neve na ka caktuar nga një detyrë, me ç'rast Ai ka shfaqur besimin e vet ndaj nesh. Sepse ne nga jeta e përditshme e dimë: Ne i dhurojmë diçka ndokujt që e duam dhe i besojmë! Kështu, pra Zoti edhe neve na ka besuar dhe na ka caktuar detyra të ndryshme! Dhe për ta realizuar detyrën e caktuar sa ma me sukses, Ai na i ka dhënë edhe dhuratat. Cilat? Psh që ju jeni veshur kështu bukur, është meritë e juaja. Shtëpiat tuaja nuk iu ka ndërtuar Zoti, por ju vet. Nëse dëshiron me pa çka të ka dhuruar Zoti, del përpara pasqyrës dhe do të zbulosh. Nuk është meritë e jotja nëse je i bukur, i mençur. Zoti të ka krijuar të tillë. Dhe me mençurinë tënde duhet të punosh për të realizuar detyrën që ta ka caktuar Zoti. Kuptoje nuk ka rëndësi ku jeton këtu apo në Perëndim, nuk ka rëndësi sa do të

jetosh 30 apo 50 vjet? Jo, më e rëndësishmja është se si jeton, me kënd bashkëpunon. Ditën kur do të ballafaqohemi me Krishtin në jetën e amshuar, Ai nuk do të na pyet neve: Pse nuk ke qenë i madh si shën Kolli? Pse nuk ke bërë mrekulli si shna Nou? Pse nuk ke shkuar në Indi për ta predikuar ungjillin si Nëna Tereze? Jo, Krishti do të thotë: Pse nuk ke qenë nxënës i mirë, pse nuk ke qenë babë apo nënë e mirë etj? Dmth Krishti do të pyet për detyrën që ta ka caktuar, sa ti atë e ke realizuar me sukses?

Kur ke lindur familja jote është gëzuar pse është pasuruar me një anëtar të ri. Dhe tani kur ti je i rritur, ti si anëtar i familjës sate mund të jesh edhe më tutje gëzimi dhe lumturia e saj, por ti mund të jesh edhe turpi dhe fatëkeqësia e saj. Me ty pra, familja jote dhe bashkësia e jonë mund të jetë më e shëndoshë, më e lumtur, por edhe më e sëmuar dhe më fatkeqe. Ta pyesim vetën: A jemi ne faktor stabiliteti, hareje dhe lumturie ne familjet tona apo jo?

Dëgjuam se sa i rreptë ishte Zotëria me shërbëtorin dembel, i cili nuk e dyfishoi kapitalin e Zotërisë siq bënë të tjerët. Jeta jonë nuk është lojë, argëtim, por përgjegjësi, është punë. Ne jemi të punësuarit e Zotit, ne jemi ata që duhet të investojmë në kapitalin dhe dhuratat që na i ka dhënë Zoti, ne jemi ata që me punë duhet të sigurojmë ardhmërinë dhe hyrjën tonë në Mbretërinë qiellore. Pra, Zotëria e dënon ashpër shërbëtorin dembel. A ne mjerisht jo vetëm që jemi dembela, por dhuratat e Zotit i keqpërdorim. Ta dëgjojmë apelin e shën Palit, *të zgjohemi nga gjumi*, dhe me aftësitë që na i ka dhënë Zoti të punojmë pa lodhshëm në të mirë dhe të mbarë të shpirttrave tanë, të familjeve tona, të rrethit tonë, të Atdheut

tonë tokësorë, por mos ta harrojmë kurrë as Atdheun tonë qiellorë. Amen.

Lutja e besimtarëve

**E diela na përkujton ngjalljen tënde dhe na dëshmon se Ti je Emanuell Hyji me ne. Pra, ne bijtë dhe bijat tua po t'i drejtojmë lutjet tona: Dëgjoje, o Zot, lutjen tonë**

- O Jezu, drita që erdhe për të shndritur errësirën e mëkatit. Mos lejo të jetojmë nën terrin e mëkatit, Djallit dhe të vdekjes, por na ndihmo të ndjekim dritën tënde, të lutemi.

- Mëkatet tona janë të shumëta dhe të shpeshta. Tregoje mëshirën Tënde në falje dhe ndërrimin e jetës sonë, të lutemi.

- Të falenderojmë, o Zot për jetën dhe talentet e shumëta që na i ke dhënë,

Ndihmona që t'i përdorim ato për të mirën dhe shëlbimin e shpirtit, të lutemi.

- Ndhmoje rininë tonë të kuptojë se bukuria dhe pasuria materiale nuk vlejnë pa bukurinë e shpirtit dhe pasurinë shpirtërore. Bëj që ne të pasurohemi gjithnjë e më tepër shpirtërisht, të lutemi.

- Për nënat tona shqiptare që fëmijët t'i pranojnë dhe t'i edukojnë me mirësi, dashuri dhe shembull të mirë, të lutemi.

- Bëj, o Jezu që dëshirat e mira, mos të mbesi vetëm fjalë apo premtime të kota, por të realizohen me perkrahjen tënde, të lutemi.

**O Zot, ne po lëshohemi në dorën tënde dhe po të lutemi, ngjallu në jetën tonë, në familjet tona dhe në popullin tonë. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.**

Don Albert **DEMAJ**

## Krishti dhe gentlmeni

- Mund të jetë edhe definim i gentlmenit kur themi se ai është mashkull i cili kurrë nuk shkakton dhimbje.

- Ai kryesisht mirret me faktin që njerëzve vetëm t'iu largon barrierat në rrugën e tyre deri tek liria dhe identiteti i tyre i plotë.

- Ai më mirë merr pjesë në ngjarjet se sa të merr iniciativën.

- Është shumë i kujdesëshëm ndaj rrethit, i ndjeshëm ndaj frikacakëve, i dashur ndaj të ndruajturve.

- Ai kurrë nuk harron me kënd bisedon; ruhet nga aluzionet e pakuptimta ose bisedat që ndokënd mund ta hidhërojnë.

- Ai rrallë herë e udhëheq bisedën dhe kurrë nuk lodhet.

- Ai kurrë nuk i përmend shërbimet kur vetë i bën.

- Me mençurinë largëpamëse nderon parimet e të urtëve, që ndaj armikut duhet të sillemi sikur një ditë do të bëhet miku ynë.

- Ai vërtet në mënyrë të shëndoshë i kupton njerëzit.

- Ai ka punë më të mençura se t'i kujtojë padrejtësitë e përjetuara.

- Ai me konceptin e vet mund të ketë të drejtë apo edhe gabim, por është tepër i arsyeshëm për të qenë i padrejtë; ai është ashtu i thjeshtë siç është edhe i bindshëm.

- Askund nuk do të gjëjmë sinqeritet, respekt, mirësi dhe dashuri më të madhe se tek Ai.

- Ai vepron me ndjenja mirësie dhe të rafinuara, që janë faza përcjellëse të civilizimit.

**Kardinali Gjon Henri Njuman**

## E DIELA XXXIV gjatë vitit - Krishti Mbreti i Gjithësisë

*Do të ulet mbi fronin e vet të madhërueshëm e do t'i ndajë njërin prej tjetri.*

**Leximi i parë:** Ez 34,11-12,15-17.

**Psalmi:** 23 (22) *Hiri dhe mirësia jote do të më përcjellin, o Zot.*

**Leximi i dytë:** 1 Kor 15,20-26.28.

**Ungjilli:** Mt 25,31-46.

*Në atë kohë, Jezusi u tha nxënësve të vet: "E kur të vijë Biri i njeriut në madhërinë e vet e me të gjithë engjëjt, do të ulet mbi fronin e vet të madhërueshëm. Atëherë para tij do të mblidhen të gjithë popujt dhe ai do t'i ndajë njërin prej tjetrit, sikurse bariu ndan delet prej cjepve. Delet do t'i vërë në të djathtën e vet e cjeptë në të majtën. Atëherë Mbreti do t'u thotë atyre që do të jenë në të djathtën e tij: 'Ejani të bekuarit e Atit tim! Merrni në pronë Mbretërinë që u bë gati që prej fillimit të botës! Sepse pata uri e më dhatë të ha, pata etje e më dhatë të pi, isha shtegtar e më përbujtët, isha i zhveshur e më veshët, i sëmurë e erdhët të më shihni, isha në burg e erdhët tek unë.' Të drejtët atëherë do t'i përgjigjin: 'Zotëri, kur të pamë të uritur e të dhamë të hash,...*

*Pastaj do t'u thotë edhe atyre që do të jenë në të majtë: 'Ikni prej meje, të mallkuar, në zjarr të pasosur, të përgatitur për djallin e për engjëjt e tij! Sepse isha i uritur e nuk më dhatë të ha, ... Atëherë edhe ata do t'i përgjigjen: 'Zotëri kur të pamë të uritur, a të etshëm..., e nuk t'u gjetëm në nevojë?' E ai do t'u përgjigjet: 'Për të vërtetë po ju tem: Çkado s'bëtë për njërin prej këtyre më të vegjëlve, nuk e bëtet për mua.'*

*Këta do të shkojnë në mundim të përjetshëm, kurse të drejtët në jetën e pasosur."*

**Fjala e Zotit**

Kremtja e Krishtit Mbretë është relativisht e vonshme, që nga viti 1925. Papa Piu IX me enciklikën e quajtur *Quas primas* si kunder përgjigje ndaj regjimeve totalitare të asaj kohe: komunizmi, fashizmi, nacizmi që pretendonin pushtimin e botës me dhunë, brutalitet, duke shkelur dinjitetin njerëzorë etj. Një politikë e tillë solli edhe Luftën e Dytë Botërore. Kurse Kisha del me një alternativë tjetër: Krishti Mbret, që e denon çdo llojë dhune, shkeljen e dinjitetit njerëzorë, duke u vu në shërbim të njeriut, kuptohet vetvetiu në frymën e ungjillit të Krishtit. Si mbështetje kishte edhe 1600 vjetorin e Koncilit të Nikesë (325). Dhe kjo festë fillimisht u kremtua të dielën e fundit të tetorit, në prag të festës së Gjithë shenjtërve, *Jezu Krishti që triumfon mbi të gjithë shenjtërit dhe të zgjedhurit e tij* (shih enciklika në fjalë). Kurse reforma liturgjike pas Koncilit të II të Vatikanit, përkatësisht më 1970 ia jep një theks tjetër: *Jezu Krishti, Mbreti i Gjithësisë* si dhe zhvendoset në dielën e fundit të vitit liturgjik. Kjo dëshmon kulmin liturgjik si dhe përfundimin e vitit kishtar, që përfshihet jo vetëm zhytja në jetën e Jezu Krishtit dhe të ungjillit të tij, por edhe veprimi aktiv i çdo besimtarit në fuqinë e sakramentit të pagëzimit për një solidaritet ndërnjerëzorë për ta realizuar Mbretërinë e Zotit, përkatësisht *ditën e shtatë*, krye i të cilit është Jezu Krishti i ngjallur Mbreti i Gjithësisë.

Gjatë këtij vitit "A" liturgjik, ungjilltari Mate e përshkruan Jezu Krishtin si *zemërbutë dhe i përvujtë* si shpëtimtar, i cili zbulon lavdinë e Atit në solidaritetin

më të varfërit dhe të vuajturit: *..pata uri e më dhatë të ha...* Krishti për ta shpëtuar njeriun nga shkatërrimi i përhershëm e merr natyrën njerëzore dhe hynë në errësirën e madhe të jetës tokësore. Që nga lindja e tij e shoqëron përndjekja (refugjat në Egjipt), i përjashtuar, i dënuar, i tradhëtuar dhe i dorëzuar vrastarëve. Për ta poshtëruar dhe për t'u tallur me *mbertërinë e tij* dënohet me vdekjen më të tmerrshme duke e kryqëzuar në mes të dy cubave në malin e Kalvarit (Golgotës). Por njëherit nepër mes kryqit, ngjalljes nga varri dhe ngritjes në Qiellë përmbushet vepra e tij e shëlbimit.

Mateu në ungjillin e sotëm na e paraqet kohen kur Jezusi do të vijë në *lavdi* si shërbetorë dhe njëherit si gjykatës. Kurse në atë ditë çdo njeri do të dalin para tij, disa për t'u shpërblyer e të tjerët për t'u denuar: *Ejani të bekuarit e Atit tim! Merrni në pronë Mbretërinë që u bë gati për ju që prej fillimit të botës!* Gjegjesisht: *Ikni, prej meje, të mallkuar në zjarr të pasosur, të përgatitur për djallin e për engjëjt e tij!*

Kush është Jezu Krishti Mbreti i Gjithësisë? Ungjilli i sotëm na flet mbi Jezusin si Mbret me dy përfytyrime, që mes vetes plotësohen: Jezu Krishti si Mbret dhe si bari. Kjo pamje figurative mbret bari mishërohet me jetën e Krishtit Shëlbues, përkatësisht shpëtimtar i njerëzimit dhe gjithësisë. Dhe njëherit Gjykatës: *Ja, unë po vij për se shpejti! Edhe shpërblimi im me mua, për të shpërblyer gjithkënd sipas veprave të tija! Unë jam Alfa dhe Omega, i Pari dhe i Fundit, Fillimi dhe Mbarimi!* (Zbul 22, 12-13). Si Bari do t'i gjykojë njerëzit si pas veprave: *Indan delet prej cjeprve. Delet do t'i vërë në të djathtën e vet e cjeptë në të*

*majtën.*

Kriteri i ndarjes janë veprat e mëshirës: *Ajo ta ndash bukën tënde me të uriturin, t'i shtish në shtëpinë tënde skamnorët e të pashtëpitë? Kur ta shohësh të zhveshurin, vishe dhe mos e përbuz farefisën tënd* (Is 58,7). Fshehtësia e Krishtit Mbret është në rrafshin e Shëlbimit, i cili mishërohet e bëhet njeri i vërtetë. Qëllimi i Jezusit është historia e njeriut, pika ku takohen qielli dhe toka, ku përpiqen të gjitha synimet e historisë dhe të civilizimit në rrafshin e gjinisë njerëzore. Ati e ngjalli nga të vdekurit dhe e ngriti duke e vendosur në të djathtën e tij nga do të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit: *Kur të plotësohej koha: dmth të vërë çdo gjë nën kryesinë e Krishtit, të gjithë qenësit që janë në qiell e në tokë.* (Ef 1,10).

Njeriu i të gjitha kohërave është kureshtar se çka do të ndodhë në të ardhmën dhe kur do të ndodh dita e gjyqit? E rëndësishme është të kuptojmë dy premisat kryesore të jetës: vertikalen dhe horizontalen. Vertikalja e lidh njeriun me transhedencen, kurse horizontalja në raportet ndër-njerëzore. Arti i jetës i çdo të krishterit është për t'i bashkuar këto dy premisa në pamjen e kryqit. Dhe çdo njëri prej neve është i aftë për çdo ditë gjatë rrugës së jetës të ballafaqohet me realitetin e jetës. Gjatë kësaj rruge po ta quajmë *Emaus* kemi mundësi t'i njohim shenjat e kohës, dhe ta njohim Atë në rrugët tona të jetës qoftë në familje, në shkollë, në punë, nëpër spitale etj. Atëherë në ditën e fundit nuk ndodhin asgjë tjetër përveç do të zbulohen ato çka kemi vepruar sot përkatësisht gjatë jetës tonë tokësore. Dita e gjyqit me fjalë të tjera ndodh tani, në këtë moment.

Ja një legjend për mbretin e katërt. *Legjenda thotë se ylli i ishte shfaqur katër*

*mbretërve, dhe të katërtit u nisën për ta kërkuar foshnjën e Betlehemit. Por, mbreti i katër ishte aq zemër mirë, sa që çdo dhuratë që kishte marrë për t'ia dhuruar fëmijës së Betlehemit, iu ndante të varfërve gjatë udhëtimit për në Betlehem. Në fund e shiti edhe kalin e tij dhe bleu gomarin, kurse parat e mbetura iu shperndau nevojtarëve. Kurse tre mbretërit tjerë me kuajt e tyre e lanë mbrapa në gomarin e tij. Para se do të arrijë në Betlehem, para tij shfaqet një pamje tronditëse, se si një njeri i ri dhe i sëmurë, babai i shumë fëmijëve e dërgojnë në burg (skllavëri), sepse nuk kishte të holla për të paguar borgjin. Pati vërtet mëshirë për të, por tani as vet nuk kishte të holla për t'ia blerë lirinë. Dhe pranoj të shkojë në vend të tij në burg. Ky mbret qendroi rreth 30 vite në burg duke punuar punë të rënda. Pasiqë kreu borgjin, e del nga burgu, u nis në rrugë në drejtim të Jerusalemit. Papritmas takohet me një tollovi njerëzish që shkonin pas njeriut që menzi barte kryqin. Në pyetjen se kush është ai, merr përgjigjen se është Jezusi që e dërgojnë për ta kryqëzuar, sepse ka pohuar se është Biri i Zotit. Mbreti dëgjon në thellësinë e zemrës një zë: Vetëm ai që ka sprovuar ligëshpinë e botës, ai është i denjë për mbretë!*

Lutja e besimtarëve

**Me fe, shpresë dhe dashuri t'i vëllëzër dhe motëra Mbretit të gjithësisë, Jezu Krishtit Zotit tonë: Ardhtë Mbretëria jote, o Zot.**

- Atë qiellorë, je i mëshirshëm me Kishën tënde në krye me Papën Benediktin e XVI, ipeshkvin tonë Markun, meshtarët, rregulltarët. Bëj që ajo të jetë mbretëri e vërtetës sate hyjnore, e drejtësisë dhe të mirës së përgjithshme, të lutemi.

- Drejto të gjithë njerëzit kah rruga e

drejtësisë sate dhe ndihmoju që të jetojnë në dashurinë vëllazërore, të lutemi.


- Na mundëso, o Zot, që ta lëvdojmë, madhërojmë dhe dashurojmë Birin tënd Jezu Krishtin me atë dashuri që Ai na deshi ne, të lutemi.

- Bëj që kudo në botë, e sidomos në popullin tonë të përhapet më ma shumë sukses Mbretëria e jote e paqës, mirësisë dhe e dashurisë, të lutemi.

- Pranojë në Mbretërinë tënde të gjithë ata që kaluan në amshim, të lutemi.

**O Zot, prano lutjet tona dhe bëj që, besimtarët tu sipas mëshirës dhe vullnesës sate, ta rindërtojnë mbretërinë qiellore këtu mbi tokë. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.**

Don Nosh **GJOLAJ**



## A e dini se...

- Shkenctarët mendojnë se gjuha më e vjetër e folur në botë është ajo e quajtur ajmara, që duket si një gjuhë artificiale e krijuar për t'u përkthyer shpejtë dhe pa vështirësi. Shkenctarët mendojnë se kjo gjuhë duhet të ketë qenë gjuha e Noes, e cila dokumentohet nëpërmjet materialeve të gjetura në varkën e tij vigane në kreshtat e Araratit, ku pa dyshim ka qenë limani i tij i fundit.

- Në botë 800 milion njerëz vuajnë çdo ditë për bukë.

- Në çdo tre sekonda në botë vdesë një njeri nga uria.

- Mjalti ndihmon shumë në qetësimin e nervave.

- Njerëzit që pinë më tepër qaj se sa kafe janë më shumë të mbrojtur nga disa lloje të kancerit: të stomakut, të mëlçisë dhe të zorrëve.

- Zogjët kanë disa lloje të tingujve me të cilët kuptohen mes veti: psh ata me tinguj shprehin urinë, kur kanë dëshirë të jenë vetëm ose kur kanë humbur.

- Bletët poashtu me lëvizje shprehin gjetjen e lules, ujit, rrezikut nga armiku etj.

- Speci ka më shumë vitamina se shumë perime të tjera së bashku.

- Nëpër veshkën e njeriut gjatë ditës kalojnë 1300 litra gjak. Konsiderohet se gjatësia e gyphave veshkorë arrin rreth 60 km.

- Te një lloj bretkoce, mashkulli vezët dhe të vegjëlit i ruan në gojë.

## Fuqia e buzëqeshjes

Edhe një buzëqeshje e vogël në buzët tua, gëzon zemrën. Buzëqeshju vetvetës derisa nuk e heton që është larguar serioziteti i rëndomtë.

Buzëqeshju vetvetës, derisa nuk e ngroh zemrën me shkëlqimin e fytyrës sate. Atëherë shko dhe shndritë me buzëqeshjen tënde.

Buzëqeshja jote e ka për detyrë ta realizojë veprën e mrekullueshme për Zotin. Buzëqeshju fytyrave të lanuna, fytyrave të pikëlluara, të sëmuara, fytyrave të freskëta dhe të reja, por edhe atyre të vjetra dhe të rrudhura. Buzëqeshju pandërpre familjë sate, miqëve tu.

Numëroj buzëqeshjet që i ka prodhuar buzëqeshja jote tek të tjerët gjatë një dite. Ky numër do të tregojë sa herë e ke zgjuar gëzimin tek të tjerët, knaqësinë, shpresën, kurajon, besimn në zemrat e tjerëve.

Buzëqeshja jote mund të jep jetë të re, shpresën dhe kurajon të lodhurve, të sëmuarve, zemrave të dëshpruara. Buzëqeshja jote mund të ndihmojë shumë njerëzit.

Por kujdes nga buzëqeshja ironike!

Dhuro buzëqeshje nga zemra dhe krijoje buzëqeshjen tek të tjerët.

Buzëqeshja është burim i gëzimit, dashurisë dhe i paqes.

## VDEKJA

Nuk duhet frikësuar prej vdekjes  
sepse vdekja është kthim në shtëpinë e Atit.  
Për mua është kurora më e madhe e jetës njerëzore:  
vdekja në paqe me Zotin...  
Frikohemi prej vdekjes vetëm atëherë kur nuk e kemi  
ndërgjegjen e pastër,  
kur frikohemi të gjendemi para vetvetes  
mu për këtë shumë njerëz frikësohen prej vdekjes:  
sepse frikohen të ballafaqohen me të vërtetën,  
të ballafaqohen me vetveten  
duke shikuar Zotin.  
Zemra e pastër e sheh Zotin,  
unë besoj që të varfërit  
jetojnë në praninë e Zotit,  
dhe shi për këtë nuk i frikohen vdekjes,  
por shkojnë me gëzim në këtë takim,  
Unë besoj...  
ata që gjenden ne Shtëpitë tona për njerëz buzë  
vdekjes,  
të gërbulurit tanë dhe të tjerët  
që i gëzohen vdekjes  
jo përse do të lirohen nga dhembjet,  
por për qetësinë që e përjetojnë.  
Paqja që ndriçon në fytyrat e tyre.  
Edhe pse mijëra njerëz  
për çdo vit vdesin nëpër shtëpitë tona, kurrë s'kam parë që  
ndonjë prej tyre të vdiste i shqetësuar  
apo i nënçmuar  
apo i frikësuar...  
thjesht shkojnë në shtëpinë e Atit.  
Vdekja është vazhdimi i jetës, plotësim i jetës  
mjet i lehtë dhe i shpejtë për t'u kthyer te Zoti...  
Kthimi tek Ai është kthim në shtëpi...

Nëna Terezë



### Na e mëso dashurinë

Zotëri, më mëso të mos flas porsi bronzi kumbues,  
apo porsi cimbali tingëllues, por me dashuri.

Ma kthe aftësinë e të kuptuarit  
dhe më jep fenë që i lëkund bjeshkët, por me dashuri.

Ma mëso atë dashuri që është gjithnjë duruese  
dhe gjithmonë e butë; askurrë ziliqare, krenare,  
vetjake apo keqmbajtëse;

Dashuri që e rys gëzimin në të vërtetën,  
e gatshme gjithnjë për të falur,

për të besuar, për të shpresuar, për të duruar.

Më në fund, kur të gjitha sendet e tejkalueshme

Të shkapërderdhen, e tëra do të jetë e qartë se mund të kem qenë e  
dobët,

por gjithnjë shkëndijë e dashurisë Sate të përkryer. Amen.

**Nëna Terezë**


### Kronika

**1.X.2005.** Në Kuqishtë të Rugovës së Pejës u bë inaugurimi i kishës së re, kushtuar shën Klementit.

**2.X.2005.** Në Ferizaj u kremtua festa e pajtorit të kësaj famullie Engjëlli i Rojës. Meshën e rastit e udhëhoqi d Rrok Gjonllëshaj, famullitar i Stubllës.

**4.X.2005.** Në Vërnakollë u kremtua shën Frani i Asizit. Meshën e udhëhoqi d Franë Sopi, famullitar i klinës.

Paga e mëkatit është vdekja, ndërsa dhuratë e Hyjit është jeta e pasosur në Jezu Krishtin, Zotin tonë. (Rom.6.23)



**Paga** - Është e drejtë të marrim pagën tonë për punën tonë. Në mënyrë të ngjashme ne meritojmë shpërblim apo dënim nga Zoti varësisht si e kemi jetuar jetën tonë.

**Mëkati** - Është mosbindja ndaj ligjeve të Zotit, ose thjeshtë kur Atë e përjashtojmë nga jeta jonë. Ka qenë Zoti ndonjëherë larg teje? Mëkati shkakton ndarjen ndërmjet Zotit dhe njeriut. Në skicë shohim dy shkëmbinj: në njërin anë njeriun, në tjetrën Zotin dhe humnerën në mes.

**Vdekja** - Mund të jetë fizike dhe shpirtërore. Vdekja është pagesa që ne meritojmë për mëkatet tona.

**Ndërsa** - Paraqet kontrastin ndërmjet pjesës së parë të vargut ku kemi një lajm të keq, dhe pjesës së dytë të vargut ku është lajmi i mirë.

**Dhurata e Hyjit** - Dhurata për të cilën bëhet fjalë është falas nga vetë Zoti dhe është aq e veçantë sa që askush tjetër nuk mundet me ta dhënë.

**Jeta e pasosur** - Në njërin anë të shkëmbit kemi vdekjen e në tjetrën jetën e pasosur. Kjo është dhurata që na ofron Zoti.

**Jezu Krishti** - Ura mes dy shkëmbinjve. Duke vdekur në kryq, Jezua Krishti ka paguar dënimin për mëkatet tona dhe kështu Ai mund t'na jep dhuratën e jetës së pasosur.

**Besimi** - Zoti dëshiron një marrëdhënie me ne. Realizojë përmes besimit.

Franc Kurti



Impresum: Ad usum Internum

Boton; Dekanati i Prishtinës

Adresa: Rr. "Rexhep Bislimi" Nr. 50, Ferizaj

E-mail: jetaliturgjike@hotmail.com

Tel.0290/20-041

Shtypi: "ERA" Ferizaj

